



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 1459 / prot.
1

Tiranë, më 31.10 2024

Vendim nr. 90 datë 31.10.2024

Për ngritjen e njësisë së kërkim-studimit në fushën e energjive të rinovueshme

Referuar nenit 19 të ligjit nr. 59/2019 "Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë"; në pajtim me nenin 45 të statutit të ASHSH; me kërkesë të akad. Ilirjan Malollari (bashkëngjitur) dhe me propozim të Seksionit të Shkencave të Natyrore dhe Teknike (bashkëngjitur), pasi u njoh me relacionin me shkrim të kryetarit të kësaj njësie për aktivitetin e saj për periudhën 2022-2023 dhe me propozimet për projektet shkencore që vijnë nga periudha dyvjeçare e funksionimit të deritanishëm dhe / ose që janë përgatitur rishtaz, me periudhë zbatimi vitet 2024-2026, Kryesia e ASHSH në mbledhjen e saj të datës ____ . ____ .2024,

V E N D O S I:

1. Të rikrijohet njësi kërkimore e përkohshme për energjitë e rinovueshme **për dy vjet të tjera, duke filluar nga data e marrjes të këtij vendimi;**
2. Grupi drejtues për njësinë e energjive të rinovueshme të ketë në përbërje:
 - Ilirjan Malollari (ASHSH)
 - Dhimitër Haxhimihali (ASHSH)
 - Floran Vila (ASHSH)
 - Besnik Baraj (ASHSH)
 - Nevton Kodhelaj (UPT)
 - Partizan Malkaj (UPT)
 - Spiro Drushku (FSHN, UT)

- Petrit Zorba (Inst. Gjeoshkencave, UPT)
- Zija Kamberi (UPT)
- Artan Leskoviku (AKBN)
- Driada Mitrushu (UPT)

3. Propozimi i paraqitur nga akad. Ilirjan Malollari për veprimtarinë e njësisë kërkimore të *energji ve rinovueshme* në dy vitet në vijim (bashkëngjitur), të shërbejë si program i përkohshëm i saj;
4. Deri në fund të muajit dhjetor 2024 të paraqitet për miratim programi përfundimtar i punës së kësaj njësie, me specifikime të plota të projekteve, konferencave, botimeve dhe nismave të tjera shkencore;
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: drejtuesit e njësisë kërkimore të *energji ve rinovueshme*, sekretari shkencor, kryetari i SSHNT e kancelari.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI,
AKADEMIK SKENDER GJINUSHI

